

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6123  
E premte, 25 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

## Shqyrtohen mbi 4 000 kërkesa për lejeqëndrim në Kosovë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**KUVENDI I MAQEDONISË  
EMËRON ZËVENDËSMINISTRAT  
E RINJ TË QEVERISË F. 2**

**ZELANDA E RE LEHTËSON  
RREGULLAT PËR MASKA F. 11**

**ZYRTARËT E KËSHILLIT TË  
EVROPËS E INFORMOJNË  
MINISTRIN SELIMI PËR TRI  
PROJEKTE KYÇE NË KOSOVË F. 6**

**KRYETARI I OEK-ut I SHEH  
VETËM DY RRUGË PËR  
KALIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR  
RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 6**



### EKONOMI

**HOTI: DO T'U NDIHMOJMË  
FERMERËVE DHE PËRPUNUESVE  
TË QUMËSHTIT F. 8**

**NGA VITI I ARDHSHËM  
PARALAJMËROHET NDRYSHIM  
I ÇMIMIT PËR TPL-në F. 8**



### SPORT

**BELEGU: LIGA UNIKE RISI  
NË BASKETBALL, SHPRESOJ  
NË CILËSI DHE RIVALITET F. 14**

# SPECIALJA NIS ARRESTIMET

Prokuroria e Specializuar, me seli në Hagë, ka bërë arrestimin e personit të parë në Kosovë të dyshuar për krime lufte. Personi i arrestuar është ish-ushtari i UÇK-së, Salih Mustafa, i njohur si komandant "Cali". Në

momentin e arrestimit Mustafa ka qenë zyrtar i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Arrestimin e tij e ka konfirmuar Zyra e Prokurorit të Specializuar, duke treguar se, pas

arrestimit, ai është nisur për në Hagë. Deri më tani mbi 200 ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë marrë në pyetje nga Prokuroria Speciale që nga fillimi i vitit 2019 ■ FAQE 4-5



## HOTI: PËR ASOCIACIONIN NUK DO TË DISKUTOHET NË BRUKSEL

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, është shprehur i bindur se çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe nuk do të diskutohet në Bruksel. Ai ka thënë se kjo çështje është mbyllur dhe nuk do të hapet më. Ndërsa presi-

denti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se kjo çështje do të jetë temë e pashmangshme në bisedimet e radhës në Bruksel. Por, ende nuk duhet nëse do të mbahet takimi i paralajmëruar më 28 shtator në Bruksel ■ FAQE 3

## ASNJË I VDEKUR NGA COVIDI NË 24 ORËT E FUNDIT NË KOSOVË

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Vdekjet e 'dyshimta' nga Covid-19

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Më 9 shtator Ragip Kajtazi nga fshati Syriganë i Komunës së Istogut mori lajmin se motra e tij vdiq në Klinikën Intensive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ku edhe ishte e hospitalizuar si paciente me Covid-19, sëmundjen që e shkakton koronavirusi. Megjithatë, ai filloi të dyshojë se motra e tij 71-vjeçare kishte vdekur nga virusi, pasi që nuk kishte marrë asnjë dokument zyrtar nga mjekët që vërtetonte se ajo kishte qenë e infektuar. "Ditën e tretë në spital më kanë njoftuar që ka Covid-19, por në përcjellje të terapisë gjendja herë ka qenë stabile e herë është përkeqësuar", thotë Kajtazi. "Çfarë ka vepruar mjekësia, unë nuk mund t'i paragjykoj ato gjëra. Ata më thanë se motra kishte vdekur nga virusi, por nuk kam marr asnjë letër (dokument) prej mjekut që ajo ka qenë pozitive me Covid-19 ose negative", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Kajtazi vendosi që dyshimet e tij t'i vërtetojë dhe kërkoi që motrës t'i bëhet autopsia. Dy ditë pasi kishte vdekur motra e tij, rezultatet dolën ndryshe nga ajo që ishte thënë më herët. "Në mostrën e testuar nuk ka prezencë të ARN-së të virusit SARS-Cov-2. Testimi është kryer me Real Time PCR", thuhet në raportin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës pas kryerjes së autopsisë.

Kajtazi tregon për "Radion Evropa e Lirë" se nuk ka mundur të marrë pjesë as në



varrimin e motrës së tij pasi që i është thënë të qëndrojnë në vetizolim për shkak se ishte vazhdimisht në shoqërim të motrës.

## Obduksion për çdo të vdekur

Një konfuzion rreth numrit të vdekjeve nga Covid-19 është krijuar edhe më datë 19 shtator. Në njoftimin e përditshëm të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) fillimisht u raportuan tri raste të vdekjes për atë ditë, por tri orë më vonë përmes një reagimi ky Institut tha se rastet e raportuara si vdekje nga Covid-19 kishin rezultuar negativë.

Neuropsikiatri Jusuf Ulaj thotë për "Radion Evropa e Lirë" se për t'i shmangur dyshimet mbi vdekjet nga ky virus, duhet që

çdo vdekje të dyshimtë t'i bëhet obduksioni. "Vdekjet nuk mund të fshihen, por dyshohet se ka interferencë edhe nga politika sa i përket dinamikës dhe numrit ditor të raportimeve. Ka raste që kalojnë infeksionin dhe dalin negativë në testim, por vazhdojnë të kenë komplikime pas kalimit të infeksionit. Pra, disa mund të vdesin pasi që e kanë trajtuar virusin dhe rrjedhimisht mund të ketë gabime në përcaktimin e saktë të shkakut të vdekjes dhe raportimit të tyre", thotë Ulaj. Mirëpo drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar (SSHUKUK), Valbon Krasniqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk ka vend për dyshime sa i përket numrit të vdekjeve nga Covid-19. Krasniqi thotë se rënia e numrit të rasteve të reja të infektuara me koronavirus nuk përcillet domosdoshmërisht

edhe me uljen e numrit të rasteve që kërkojnë trajtim spitalor në mënyrë të menjëhershme. "Inkubacioni i këtij infeksioni sillet nga një deri në dy javë. Atëherë është e pritshme që pas kësaj periudhe kur fillon të bjerë numri i rasteve të reja, do të fillojë të bjerë edhe numri i rasteve të hospitalizuara. Po ashtu, edhe numri i atyre që përfundojnë me fatalitetet nuk pritet të zvogëlohet, të paktën deri në dy javë prej kur fillon të ulet numri i rasteve të reja të infektuara", thotë Krasniqi.

## Besimi i luhatur në sektorin e shëndetësisë

Rasti i familjes Kajtazi nuk është i pari në Kosovë. Një rast tjetër ka ndodhur gjatë muajit prill. Pas dyshimeve që patën familjarët e një gruaje 39-

vjeçare nga Istogu, që ishte viktima e tetë nga koronavirusi në Kosovë, kërkuan që t'i bëhej autopsia.

Asnjë nga familjarët e saj nuk kishin rezultuar pozitivë me koronavirus, andaj me kërkesë të tyre trupi ishte zhvarrosur për t'iu kryer autopsia.

Rezultatet vërtetuan se ajo nuk kishte qenë e infektuar. Në fillim të muajit korrik, saktësisht më 5 korrik, disa familjarë ngritën dyshime për vdekjen e të afërmeve të tyre që ishin të shtrirë në Klinikën Infektive si pacientë me Covid-19.

## Numër i vogël i testeve

Derisa në Kosovë brenda ditës nuk bëhen më shumë se 500 teste, në vendin fqinj, Maqedoninë e Veriut, bëhen nga 1 000 deri 1 500 teste në ditë për këtë lloj të virusit. Infektologu Hamdi Ramadani thotë se për t'u bërë një vlerësim real i gjendjes me Covid-19, në Kosovë duhet të bëhen më shumë teste. "Numri i të testuarve është shumë i vogël, jashtëzakonisht i vogël. Pa e ditur sa kemi njerëz të testuar dhe sa i kemi pozitivë e sa negativë, ne e kemi të vështirë ta vërtetojmë se si do të sillet sëmundja pas një jave ose tri jave", thotë Ramadani.

Rastet e para me koronavirus në Kosovë janë paraqitur në muajin mars. Që nga ajo kohë, mbi 15 mijë qytetarë të Kosovës janë infektuar me koronavirus dhe rreth 13 mijë janë shëruar. Derisa si pasojë e koronavirusit, sipas të dhënave zyrtare, kanë vdekur mbi 600 persona.

# Kuvendi i Maqedonisë emëron zëvendësministrat e rinj të qeverisë

SHKUP, 24 SHTATOR (ER) - Me 62 vota "për", Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka emëruar zëvendësministrat e rinj të "Qeverisë Zaev 2". Të pranishëm në sallë në momentin e votimit kanë qenë 106 deputetë, ndërsa 44 kanë votuar "kundër" dhe asnjë nuk ka abstenuar.

Zëvendësministër i Mbrojtjes është votuar Bashkim Hasani, zëvendësministër i Punëve të Brendshme Nazim Bushi, Agim Nuhiu është votuar zëvendësministër i Drejtësisë, Ilhan Rahman është votuar zëvendësministër, i cili do ta udhëheqë Ministrinë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie mes Bashkësive, ndërsa Fatmire Isaku

zëvendësministre e Punëve të Jashtme.

Zëvendësministër i Financave është Dimitar Kovačevski, në Ministrinë e Ekonomisë Zoran Manevski, ndërsa në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave, Trajan Dimkovski. Ilir Hasani zëvendësministër i Shëndetësisë, Arafat Shabani në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Enver Huseini në Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale, Zoran Dimitriovski në Ministrinë për Pushtet lokal, ndërsa Sedat Sulejmani në Ministrinë e Kulturës.

Për zëvendësministër të Shoqërisë Informatike dhe Administratës është votuar



Aleksandar Bajdevski, në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve Bekim Rexhepi, ndërsa dhe Planifikimit Hapësinor, Hristina Oxhaklievska.

Nuk dihet ende nëse do të mbahet takimi i radhës ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel

## Hoti: Asociacioni nuk do të diskutohet në Bruksel

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, është shprehur i bindur se çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe nuk do të diskutohet në Bruksel. Ai ka thënë se kjo çështje është mbyllur dhe nuk do të hapet më. Ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se kjo çështje do të jetë temë e pashmangshme e bisedimeve të radhës në Bruksel. Ende nuk duhet nëse do të mbahet takimi i paralajmëruar më 28 shtator në Bruksel



EPOKA  
ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Kryeministri Kosovës, Avdullah Hoti, ka përsëritur edhe një herë se marrëveshja për asociacionin e komunave me shumicë serbe është e mbyllur. Në një konferencë për media, ai ka thënë se për këtë temë nuk do të diskutohet më me Serbinë në takimet e Brukselit. "Kjo temë nuk diskutohet sepse është mbyllur me marrëveshjen e vitit 2013, pastaj marrëveshja tjetër me parime e vitit 2015 që, në fakt, e përmirëson marrëveshjen e vitit 2013. Pra, kjo nuk është temë që hapet në procesin e dialogut", ka thënë Hoti.

Hoti nuk ka konfirmuar nëse takimi i ardhshëm në Bruksel me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, i paraparë për 28 shtator, do të mbahet apo jo. "Nuk e di a do të mbahet takimi në Bruksel a jo, do ta shihet në ditët e ardhshme, por ne jemi të vendosur që ta çojmë përpara procesin e dialogut sepse është interes strategjik i Kosovës, i rajonit dhe Evropës që sa më shpejt të përmbyllet kjo çështje në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe rajoni të udhëtojë drejt integriteteve evropiane", ka deklaruar Hoti.

Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të enjten në një adresim për media ka deklaruar se Beogradi është i

gatshëm ta vazhdojë dialogun me Kosovën në Bruksel, duke theksuar se asociacioni i komunave me shumicë serbe është temë e pashmangshme. Presidenti i Serbisë ka vlerësuar se pala serbe do të insistojë që të diskutohet për temën e Asociacionit, mirëpo ende nuk dihet nëse do të mbahet takimi i radhës i nivelit të lartë në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, i cili është paraparë të mbahet më 28 shtator.

Jozyrtarisht është thënë se nëse pala e Kosovës refuzon të diskutojë për refuzimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, atëherë ky takim nuk mund të mbahet. Ditë më parë Presidenca e Kosovës ka bërë me dije se hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave me shumicë serbe në dialogun e Brukselit është gabim shumë i rrezikshëm i Qeverisë së Kosovës.

Përmes një deklarate për media, Presidenca ka vlerësuar se një gjë e tillë është goditje ndaj shtetësisë dhe cenim i sovranitetit të shtetit. "Hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave serbe në dialogun e Brukselit është gabim i madh dhe shumë i rrezikshëm i Qeverisë së Kosovës. Është goditje ndaj shtetësisë dhe cenim i sovranitetit të shtetit tonë. Këto tema janë adresuar dhe

zgjodhur në kuadër të Pakos së Ahtisaarit, e cila i parapriu shpalljes së pavarësisë, por edhe në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit në prillin e vitit 2013 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, askush nuk ka mandat që të bisedojë në emër të Kosovës për tema të mbyllura, në Bruksel apo kudoqoftë. Kosova nuk mund dhe me asnjë çmim asnjëherë nuk do të lejojë që brenda territorit të vet të krijohet një entitet politik, i cili

do të ishte riprodhim i Republikës serbe në territorin e Kosovës", është thënë në dekoratën për media të Presidencës.

Formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe është paraparë me marrëveshjen e parë të Brukselit të vitit 2013, të arritur në dialogun Kosovë - Serbi. Detajet konkrete janë harmonizuar me parimet/elementet e përgjithshme nga marrëveshja

e vitit 2015, mirëpo Gjykata Kushtetuese në dhjetor të vitit 2015 pati vlerësuar se Marrëveshja për Asociacionin në 23 pika të saj nuk është në harmoni me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar që akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe statuti që implementon parimet, për të qenë në pajtueshmëri me frymën e Kushtetutës, duhet t'i plotësojë standardet kushtetuese.

## ATK-ja dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit shtojnë veprimet për bashkëpunim

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në muajin maj 2020 kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit përmes të cilit mundësohet komunikimi i drejtpërdrejtë, i vazhdueshëm dhe i pandërprerë ndërmjet ATK-së dhe Prokurorisë së

Shtetit, me qëllim që përmes përpunimit të të dhënave të caktuara, ATK-ja t'i ofrojë Prokurorisë së Shtetit të dhëna dhe informacione të mjaftueshme për nisjen dhe zhvillimin e hetimeve penale, për veprat penale kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe shpëlarjes së parasë.

Me qëllim të njoftimit dhe prezantimit të rezultateve të deritanishme, si dhe vështirësive me të cilat ballafaqohemi, të enjten është mbajtur një takim i përbashkët në mes të ATK-së, Zyrës së Kryeprokurorit (koordinatorit të caktuar nga kryeprokurori), UNDP-së dhe këshilltarit nga Ambasada e Britanisë së Madhe

në Kosovë. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit nga ATK-ja kanë prezantuar të dhënat e përpunuara të siguruar nga ARC-ja, ARBK-ja, DK-ja dhe kryqëzimit të tyre me informatat me të cilat disponon ATK. ATK-ja ka kërkuar nga Zyra e Kryeprokurorit dhe UNDP-ja të organizohet një takim i përbashkët i kryesuar nga ZK me

të gjitha institucionet relevante nga të cilat do të kërkohet ofrimi i informatave në formë elektronike (të automatizuar), informata të cilat duhet të jenë të standardizuara sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së, gjithnjë në funksion të implementimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.



SALIH MUSTAFA, I ARRESTUARI I PARË I GJYKATËS SPECIALE

# SPECIALJA NIS ARRESTIMET

Prokuroria e Specializuar, me seli në Hagë, ka bërë arrestimin e personit të parë në Kosovë të dyshuar për krime lufte. Personi i arrestuar është ish-ushtari i UÇK-së, Salih Mustafa, i njohur si komandant “Cali”. Në momentin e arrestimit Mustafa ka qenë zyrtar i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Arrestimin e tij e ka konfirmuar Zyra e Prokurorit të Specializuar, duke treguar se, pas arrestimit, ai është nisur për në Hagë. Deri më tani mbi 200 ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë marrë në pyetje nga Prokuroria Speciale që nga fillimi i vitit 2019

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar, me seli në Hagë, ka njoftuar të enjten se ka bërë arrestimin e parë në Kosovë. I dyshuari i parë që është arrestuar nga Gjykata Speciale është ish-ushtari i UÇK-së, Salih

Mustafa, zyrtar i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Arrestimin e tij e ka konfirmuar Zyra e Prokurorit të Specializuar. “Salih Mustafa u arrestua sot në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në bazë të një fletarrestimi, urdhri për transferim dhe aktakuzës së

konfirmuar, të lëshuara nga një gjykatës i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës”, është thënë në njoftimin për media të Speciales, duke shtuar se ai menjëherë është nisur drejt Hagës. “Z. Mustafa po transferohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në

Hagë dhe do të dalë para gjykatësit të procedurës paraprake pa vonesë të papërligjur”, është theksuar në njoftim.

Ndërsa misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX, ka treguar se u ka dhënë mbështetje operacioneve të prokurorisë në këtë arrestim. “Siç është cekur në komunikatën për shtyp, të lëshuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZSP), sot në Kosovë është arrestuar Salih Mustafa nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në bazë të urdhër-arrestit, urdhrit për transferim dhe aktakuzës së konfirmuar, të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Misioni për Sundimin e Ligjit

në Kosovë (EULEX) i ka dhënë përkrahje operationale dhe logjistike ZSP-së në bazë të mandatit të tij dhe në përputhje me legjislacionin e Kosovës”, është thënë në njoftimin e EULEX-it.

Sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, policia në kuadrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ka autoritetin dhe përgjegjësinë që t'i ushtrojë kompetencat që i janë dhënë policisë së Kosovës sipas ligjeve të Kosovës.

Në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar gjithashtu përcaktohet se personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuzë, merret në ndalim në zbatim të urdhër-arrestimit ose



fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara. Në komunikatën e Zyrës së Prokurorit nuk është sqaruar nëse aktakuza ndaj Mustafës është ajo e cila është paraqitur në shkurt, sikundër që nuk janë dhënë detaje as për përmbajtjen që ka aktakuza. Në bazë të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara, pas konfirmimit të aktakuzës i dyshuari merr statusin e të akuzuarit dhe aktakuza i

dorëzohet personalisht të akuzuarit. Paraqitja e parë e të akuzuarit në gjykatë bëhet brenda shtatë ditësh pas dorëzimit të aktakuzës. Aktakuza është në dispozicion të publikut vetëm kur ajo konfirmohet nga gjykatësi i procedurës paraprake. Pas seancës së parë, gjyqtari i procedurës paraprake konfirmon se çështja është e gatshme për gjykim, ndërsa kryetari i Dhomave të Specializuara formon një

panel gjykues, përgjegjës për zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky panel kujdeset që gjyqi të jetë i drejtë dhe i shpejtë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë themeluar pesë vjet më parë nga Kuvendi i Kosovës për t'i hetuar krimet e pretenduara kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe vepra të tjera penale në lidhje me pretendimet e përfshira në Raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2011. Mustafa ishte intervistuar nga prokurorët e Dhomave të Specializuara, në nëntor të vitit të kaluar, në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte.

Deri më tani, mbi 200 ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë marrë në pyetje nga Prokuroria Speciale që nga fillimi i vitit 2019. Arrestimi i Sali Mustafës, ish-pjesëtar i UÇK-së, ndodhi në kohën kur brenda tri javësh, tri herë me radhë persona anonim lanë në zyrat e organizatave të veteranëve të UÇK-së, dokumente që pretendohet se janë të Gjykatës Speciale. Prokuroria Speciale për këtë çështje ka nisur hetimet. Ajo ka deklaruar se disa aktivitete në të cilat është përfshirë

Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) kanë për qëllim ta minojnë administrimin e drejtësisë në mënyrë të duhur.

Më 24 qershor të këtij viti Zyra e Prokurorit të Specializuar ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë publikuar.

### Specialja më s'ka kredibilitet për drejtësi

Kryetari i Organizatës së Veteranëve i Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka deklaruar se me nxjerrjen e mijëra dosjeve në publik Gjykatës Speciale i ka humbur kredibiliteti. Ai ka thënë se kjo gjykatë më nuk mund të vendosë drejtësi.

Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka treguar se synimi i OVLUÇK-së është ta dëmtojë Gjykatën Speciale dhe jo Kosovën. "Mendoj se Gjykatës Speciale i ka humbur kredibiliteti. Kjo gjykatë s'ka më imazh për të bërë drejtësi. Kjo mund ta

vazhdojë punën, por nuk ka aspak kredibilitet. Kësaj gjykate i kanë dalë gjërat nga dora. Ky institucion më nuk mund të vendosë drejtësi. Por, këta janë evropianë, nuk e kanë fort gajle këtë gjë. Këta mund të ngrehin aktakuza, mund ta vazhdojnë punën, por kjo gjykatë më s'ka kredibilitet", ka thënë Gucati. Ai ka deklaruar se pas këtij skandali kjo gjykatë do të duhej të mbyllej. "Më pas pak nder kjo gjykatë do të duhej të thoshte se deri këtu e ka pasur misionin. Është munduar të gjejë prova, por nuk ia ka arritur. Pra, do të duhej që kësaj gjykate t'i vihej një dry i madh dhe të mbyllej", është shprehur Gucati.

### Angazhimi i Salih Mustafës nga LKÇK-ja deri në FSK

Sali Mustafa "Cali" ka qenë pjesë e organizimit të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) që nga viti 1988, nën udhëheqjen e Afrim Zhitisë, Fahri Fazlisë e Fadil Vatës. Gjatë veprimtarisë ilegale ishte arrestuar nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit në vitin 1993 dhe është dënua me pesë vjet burgim për organizim të kryengritjes së armatosur. Në gusht të vitit 1997, pasi që përfundoi dënimin me burgim, Mustafa ishte angazhuar për organizimin dhe shtrirjen e UÇK-së në rajonin e Prishtinës, Obiliqit, Gjilanit, Vitësë e Kamenicës. Ka udhëhequr njësitet guerile të UÇK-së nën emrin guerilja BIA (Bahri-Ilir-Agron-Bahri Fazliu, Ilir Konushevcu dhe Agron Rrahmani) deri me themelimin e zonave operative të Llapit dhe Karadakut. Në kohën kur Forcat e Sigurisë së Kosovës njiheshin si Trupa Mbrojtëse të Kosovës, Mustafa ka shërbyer atëbotë si shef i departamentit informativ. Ndërsa në momentin e arrestimit, ai ka qenë zyrtar i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes.

## Ellis: Rrjedhja e dokumenteve sekrete nga Haga mund ta rrezikojë punën e gjykatës

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve me seli në Londër, dr. Mark Ellis, ka deklaruar se rrjedhja e dokumenteve sekrete nga Haga mund ta rrezikojë punën e kësaj gjykate. Për "Radion Evropa e Lirë" ai ka vlerësuar se kjo është një krizë e vërtetë. "Ky është frikësim i pastër dhe sulm mbi gjyqin, mbi procesin, mbi gjyqin e drejtë. Nëse jeni në një mjedis, ku grupe ose individë ofrojnë

informacione për emrat dhe adresat e dëshmitarëve, atëherë i gjithë procesi, në thelb, kolapson. Nuk mund të funksionojë", ka deklaruar Ellis, i cili është edhe ekspert i së drejtës penale ndërkombëtare. Sipas tij, prokuroria është përgjegjëse për t'iu përmbajtur fuqishëm mbrojtjes së identitetit të dëshmitarëve. "Kjo duhet të ndalojë. Në të kundërtën, rrezikohet i tërë procesi gjyqësor", ka deklaruar ai.

# Shqyrtohen mbi 4 000 kërkesa për lejeqëndrim në Kosovë

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agim Veliu, të enjten ka vizituar Divizionin për të Huaj, Viza dhe Leje Qëndrimi. Qëllimi i kësaj vizite ishte për ta parë punën e këtij divizioni i cili funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion dhe është përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen e aplikimeve për shtetësi.

Po gjatë kësaj vizite ministri Veliu u njoftua me punën dhe procesin e aplikimit dhe u sigurua se kriteret dhe kërkesat ligjore janë dhe do të respektohen në të gjitha rastet pa dallim. Gjatë vitit 2019 ky divizion ka shqyrtuar 6 800 kërkesa për leje qëndrim dhe 1 444 kërkesa për viza, ndërsa deri më tani, në vitin 2020, ka shqyrtuar mbi 4 000 kërkesa për leje qëndrim.



# Zyrtarët e Këshillit të Evropës informojnë ministrin Selimi për tri projekte kyçe në Kosovë

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, të enjten është takuar me shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Frank Power dhe zyrtarë të KiE-së. Gjatë këtij takimi ministri Selimi e ka njoftuar shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, Power, për disa procese prioritare të MD-së, si rishikimin funksional të sundimit të ligjit, i cili tashmë është në fazën përfundimtare, legjislacionin lidhur me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit, ecurinë e ligjit për funksionalizimin e Gjykatës Komerciale, procesin e hartimit të raportit nga Grupi Punues për llogaridhënie, duke përfshirë edhe Vettingun, si dhe një sërë çështjesh që lidhen me reformën në drejtësi.

Ministri Selimi ka falënderuar Këshillin e Evropës për mbështetjen e vazhdueshme

që i ka dhënë Kosovës, veçanërisht në sektorin e drejtësisë përmes projekteve të ndryshme.

Ministri Selimi nga zyrtarët e KiE-së u informua për tri projekte kyçe të Këshillit të Evropës në Kosovë, respektivisht Projektin kundër Krimin Ekonomik PECK III, Përforcimin e luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - faza II VAW, si dhe për Forcimin e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Kosovë KoSEJ II.

Veçanërisht është diskutuar për njërin nga projektet e KiE-së me Ministrinë e Drejtësisë, për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave nga sektori i drejtësisë sipas metodologjisë së CEPEJ-it, rezultatet e së cilës analizë dhe të dhënat e grumbulluara kanë shërbyer edhe në procesin e Rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, si dhe më pas në procesin e hartimit të Strategjisë Sektoriale për



Sundimit e Ligjit. Me këtë rast, ministri Selimi tregoi se si rezultat i këtij projekti Ministria e Drejtësisë është duke punuar për themelimin e një njësie për analiza dhe statistika në Ministrinë e Drejtësisë, e cila do të jetë njësi koordinuese dhe përgjegjëse për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave nga sektori i drejtësisë.

Ndërsa Power e ka falënderuar ministrin Selimi në emër të Këshillit të Evropës për bashkëpunimin e frytshëm përgjatë këtyre viteve dhe e ka vlerësuar shumë pozitiv seriozitetin me të cilën Qeveria e Kosovës i referohet ekspertizës së Komisionit të Venecias, që dëshmon vullnetin e vendit tonë për ta respektuar

demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut.


Ministri Selimi dhe shefi i Zyrës së KiE-së, Power, kanë shprehur gatishmërinë për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Evropës në çështjet kyçe të cilat e avancojnë sistemin tonë të drejtësisë.

## Policia e Kosovës arreston edhe dy persona të dyshuar në rastin Karaçeva

PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar edhe dy persona të tjerë që dyshohet se janë të lidhur me rastin e njohur "Karaçeva".

Përmes një komunikate, policia ka njoftuar se ka arrestuar këta persona pas dyshimeve se ata janë marrë me kontrabandim të mallrave në periudhën 2019-2020 nga territori i Serbisë në Kosovë. Sipas këtij institucioni, përmes këtyre veprimeve të dyshuarit i kanë shkaktuar dëme të mëdha buxhetit të shtetit.

Me vendim të prokurorit të



arrestuarit do të jenë në mbajtje për 48 orë.

Të hënën në Gjykatën Themelore të Gjilanit është mbajtur një seancë ndaj 30 personave që janë arrestuar më 19 shtator gjatë aksionit të Policisë së Kosovës në fshatin Karaçevë.

Në total, policia atë ditë ka arrestuar 35 persona, 12 prej të cilëve ishin policë.

Gjatë aksionit policor të 19 shtatorit janë rrënuar edhe 12 objekte në të cilët zhvillohej veprimtaria e bixhozit dhe lojërave të fatit.

Në mars të vitit 2019 Kuvendi i

Kosovës kishte miratuar ligjin që ndalon funksionimin e bizneseve të lojërave të fatit për 10 vjetet e ardhshme.

Vendimi për mbylljen e lojërave të fatit kishte ardhur, pasi në dy kazino në qytete të ndryshme të Kosovës ishin vrarë dy persona.

Edhe pas vendimit të qeverisë në atë kohë, Policia e Kosovës ka njoftuar se në aksione të ndryshme ka hasur dhe arrestuar persona të cilët ishin dyshuar se me qëllim të përfitimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme, kanë organizuar lojëra të fatit.

## Kryetari i OEK-ut i sheh vetëm dy rrugë për kalimin e Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Në seancën e sotme (e premte) të Kuvendit të Kosovës është në rend dite Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se janë dy rrugë për votimin e Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se ruga e parë është miratimi në lexim të parë dhe pastaj amendamentimi përmbajtësor në leximin e dytë, ndërkaq ruga e dytë është tërheqja e

versionit aktual të projektligjit nga ana e qeverisë dhe fuzionimi i dy versioneve (të pozitës dhe opozitës) në një ligj të vetëm. "Nga komunikimet e këtyre ditëve me aktorë të pozitës dhe të opozitës, është e qartë se ka një afrim të qëndrimeve sa i përket përmbajtjes, por jo edhe formës të miratimit të ligjit", ka thënë Rukiqi. Ai ka theksuar se është momenti vendimtar që të gjithë të reflektojnë dhe përfundimisht të kemi një ligj për rimëkëmbjen ekonomike. "Në këto situata, pritjet janë për një reflektim më të shpejtë dhe më të madh nga ana e



qeverisë", ka thënë kryetari i OEK-ut.

Në mungesë të kuorumit

javën e kaluar deputetët e Kuvendit të Kosovës sërish kishin dështuar ta miratojnë

Projektligjin për rimëkëmbjen ekonomike nga pandemia Covid-19. Në seancë kishin marrë pjesë në votim vetëm 41 deputetë, ndërsa votimi për këtë Projektligj është bartur për seancën e radhës.

Ky projektligj po ashtu nuk kishte marrë votat në lexim të parë as në muajin gusht, pasi Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës refuzuan ta votojnë, ndonëse ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, bëri thirrje për votimin e tij.

Me anë të këtij projektligji parashihet zbatimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej 365 milionë eurosh.

# Asnjë i vdekur nga Covidi në 24 orët e fundit në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka raportuar të enjten për 63 raste të reja me Covid-19 pas marrjes së 592 mostrave. Sipas këtij Instituti, përgjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimitë si pasojë e këtij virusi. Autoritetet shëndetësore kanë raportuar më 24 shtator për 87 persona që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive janë edhe 1 730



komuna Malishevë 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Gjakovë, Istog, Obiliq, Pejë dhe Rahovec.

Gjatë 24 orëve të fundit në

Spitalin e Përgjithshëm në Pejë, 190 pacientë kanë marrë trajtim emergjent shëndetësor dhe nga këta 17 pacientë janë shtrirë për trajtim të mëtutjeshëm.

Tre pacientë me Covid-19 janë

shëruar gjatë 24 orëve të fundit. Sa i përket gjendjes së pacientëve, tetë pacientë janë në oksigjenoterapi dhe nga këta dy pacientë janë në gjendje më të rëndë.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Në 24 orët e fundit në Kosovë nuk është shënuar asnjë viktimitë nga Covid-19. Lajmin e ka dhënë Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK). IKShPK-ja ka konfirmuar të enjten edhe për 63 raste pozitive me Covid-19 në 24 orët e fundit.

Numri total i rasteve pozitive është 15 333 raste nga 64 230 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 616 raste të

vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 87 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 12 987 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 730.

Rastet pozitive në 24 orët e fundit janë nga: komuna Prishtinë 24 raste, komuna Lipjan 7 raste, komuna Mitrovicë 6 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Deçan 2 raste,

## Infermierët e FSK-së përfundojnë misionin për ofrimin e shërbimeve në klinikat Covid të QKUK-së



PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Dymbëdhjetë infermierë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë përfunduar misionin e tyre 30-ditësh për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët me Covid në Klinikën Infektive, të Pulmologjisë dhe në Mjekimin Intesiv Qendror Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Me rastin e përfundimit të këtij misioni, Valbon Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të

Kosovës, ka falënderuar infermierët për punën, angazhimin dhe përkushtimin që kanë treguar për t'i ndihmuar pacientët e shtrirë në klinikat Covid. "Imputet dhe komentet që kam marrë nga menaxherët të klinikave janë inkurajuese për gatishmërinë, për përvojën dhe për aktivitetin e tyre që kanë treguar gjatë qëndrimit njëmuor në klinika. Ka pasur përkushtim të jashtëzakonshëm për punë dhe besoj se ka pasur hapësirë që, krahas ofrimit të shërbimeve për pacientë, t'i

shkëmbejnë edhe përvojat e tyre me kolegët infermierë të këtyre klinikave, pasi këtu dihet se është shërbim i natyrës tjetër, është shërbim civil që dallon nga shërbimi ushtarak" ka thënë Krasniqi.

Shkelzen Sylja, drejtor i Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës (QMFSK), ka falënderuar infermierët e FSK-së, edhe menaxhmentin e ShSKUK-së, për punën e shkëlqyer që kanë treguar gjatë këtyre ditëve. "Ka qenë detyrë dhe obligim yni që t'i përkrahim

institucionet civile në rastet e tilla ku situata epidemiologjike është veçantë, si është pandemia në tërë botën. Punën që keni bërë bashkë me kolegët e juaj për menaxhimin e kësaj pandemie, do të vazhdojmë me përkrahje, siç jemi përkrahur nga ShSKUK, do të vazhdojë bashkëpunimi si një trupë në shërbimin shëndetësor publik dhe do të menaxhojmë në mënyrë më të mirë të mundshme", ka thënë drejtori i Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Lindita Berisha, ushtruese në detyrë e drejtoreshës së Klinikës Infektive dhe Rukije Mehmeti, drejtoreshë e Klinikës së Pulmologjisë, kanë treguar përvojat e tyre gjatë punës që ekipi i infermierëve të FSK-së ka bërë në klinikat që ato menaxhojnë. Në shenjë falënderimi për punën dhe angazhimin e treguar, drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka ndarë mirënjohje për infermierët e FSK-së dhe drejtorin e Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

# Komiteti i Gastronomisë i Odës Amerikane kërkon lehtësimin e masave ndaj bizneseve HORECA

Prishtinë, 24 shtator (ER) - Komiteti i Gastronomisë dhe Turizmit i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e anëtarëve lidhur me masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës që kufizojnë aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve të industrisë HORECA.

Komiteti i Gastronomisë dhe Turizmit cilëson se kufizimi i orarit të lëvizjes dhe ndalesa e përdorimit të ambientit të brendshëm në aktivitetet e subjekteve afariste si në restorante, bare, pube, pengon rimëkëmbjen e këtyre bizneseve dhe zhvillimin e lirë të aktivitetit ekonomik në një ekonomi të tregut me konkurrencë të lirë, derisa një praktikë e tillë ka implikime të dëmshme në zhvillimin ekonomik dhe

përkeqësimin e ambientit të të bërit biznes.

Të njëjtin efekt ka edhe vonesa për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike të lidhura edhe me vonesat për aprovimin e legjislacionit përkatës, e cila, mes të tjerash, pamundëson edhe zbritjen e normës së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSh) në 8 për qind. Kjo ndikon në rimëkëmbjen e bizneseve të kësaj fushe, kurse aprovimi më i shpejtë i ligjit do të kishte ndikim në lehtësimin e operimit të ndërmarrjeve të prekura nga ndikimi i pandemisë Covid-19.

Vendimi për kufizimin e lëvizjes dhe ndalesën e qëndrimit, ngrënies dhe pirjes në ambiente të mbyllura, po ndikon negativisht në operimet e subjekteve afariste përmes



kufizimit të numrit të klientëve. Komiteti i Gastronomisë dhe Turizmit konsideron se vendimi për ndalimin e qëndrimit brenda dhe kufizimin e orarit të lëvizjes padyshim se ka implikime edhe në zvogëlimin e të ardhurave nga shitjet, e që pamundëson zgjerimin dhe

zhvillimin e sektorit HORECA. Rrjedhimisht, Komiteti i Gastronomisë dhe Turizmit konsideron se çdo efekt pozitiv i gjeneruar nga një politikë e tillë do të mbipeshohej nga ndikimet negative që ka në ekonominë e vendit dhe bizneset. Prandaj, konsiderojmë se angazhimi i

institucioneve të qeverisjes lokale duhet të jetë i bazuar në krijimin e një mjedisi të shëndoshë për sektorin privat i cili krijon parakushte për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror gjatë kësaj periudhe.

Përfundimisht, Komiteti i Gastronomisë dhe Turizmit i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë kërkon nga Qeveria e Kosovës që në koordinim me ministrinë dhe institucionet përkatëse t'i rivlerësojnë masat e vendosura, ta lejojnë qëndrimin në ambiente të mbyllura, në restorante, bare dhe pube, gjithmonë duke respektuar masat e vendosura nga IKShPK-ja, ta largojnë kufizimin e lëvizjes së qytetarëve dhe ta bëjnë votimin e Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike.

## Nga viti i ardhshëm paralajmërohet ndryshim i çmimit për TPL-në



PRISHTINË, 24 SHTATOR (ER) - Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare në Bankën Qendrore të Kosovës, Sokol Havolli, dhe kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi, kanë mbajtur të enjten konferencë për media. Zëvendësguvernatori i BQK-së ka paralajmëruar ulje të polisave për çmimin e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve (TPL), bazuar në çmimet e tregut dhe liberalizimin e kësaj industrie.

Havolli ka thënë se BQK-ja ka marrë një sërë masash sa i përket industrisë së sigurimeve. Ai ka bërë me dije se nga fillimi i vitit të ardhshëm TPL-ja do të paguhet në bazë të rrezikshmërisë individuale dhe, po ashtu, do të bëhet liberalizimi i tregut në këtë industri. "Çmimet duhet të jenë të përcaktuara nga tregu. Modeli i polisave duhet të jetë i bazuar në riskun e gjithsecilit, lëvizje drejt liberalizimit. Në fillim të vitit të ardhshëm duhet ta kemi modelin e ri të çmimeve për TPL", ka thënë Havolli.

## Nënshkruhet marrëveshja e mirëkuptimit mes MEA-së dhe FMK-së për kualitet të ajrit

Prishtinë, 24 shtator (ER) - Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit të enjten është nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi në mes të ministrisë dhe Fondacionit të Mileniumit të Kosovës (FMK).

Në këtë marrëveshje, që u nënshkrua nga ministri i MEA-së, Blerim Kuçi dhe drejtori ekzekutiv i FMK-së, Petrit Selimi, parashihet që të përkrahet aktiviteti "Dig Data" që ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave për kualitet të ajrit.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që ta nxisë bashkëpunimin për

zbatimin e projektit që ka për bazë qeverisjen transparente dhe llogaridhënëse. Të dhënat e mbledhura për kualitetin e ajrit do të jenë transparente për publikun dhe për shfrytëzim analitik. Sipas ministrit Blerim Kuçi, transparenca është një element që do të ketë rëndësi të veçantë gjatë qeverisjes së tij në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Gjatë nënshkrimit të kësaj marrëveshje mori pjesë edhe Sarah Olmstead, drejtore e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (KSM/MCC) për Kosovë.





# Hoti: Do t'u ndihmojmë fermerëve dhe përpunuesve të qumështit

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ka dy javë që prodhuesit e qumështit kanë vështirësi në plasimin e qumështit të tyre. Gjatë këtyre ditëve Ministria e Tregtisë dhe AVUK-u kanë punuar për t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore që i ka në kompetencë qeveria, për ta përmirësuar situatën sa i përket sektorit të qumështit.

Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se qeveria do ta subvencionojë shumë këtë sektor për litër të qumështit dhe në kategori të ndryshme për cilësi të qumështit. "Duket se për shkak të situatës që është krijuar në treg, kryesisht nga pandemia,

ka ngopje të tregut me qumësht dhe si rezultat përpunuesit e qumështit, ata që e nxjerrin qumështin në treg, e kanë të pamundshme ta shesin atë në treg dhe rrjedhimisht kanë vështirësi që të pranojnë qumësht nga fermerët", është shprehur ai, duke theksuar se gjatë këtyre ditëve kanë bërë edhe analizat e nevojshme në dy fronte, përmes Ministrisë së Tregtisë me Inspektoratin e Tregut, për t'u siguruar që në treg konsumatorët të dinë çfarë blejnë. Sipas kryeministrit, ka mjaft vërejtje që konsumatorët nuk janë të qartë në produktin që blejnë se a është me vaj palme apo është produkt me bazë qumështi. "Inspektorati i Tregut dhe Ministria e Tregtisë, por

edhe ministri, sot janë në terren për t'u siguruar që në markete, kudo që shitet qumësht dhe produkte të tjera, bëhet e qartë pra që shiten në lokacione të ndryshme brenda marketeve, produktet që janë me bazë të vajit të palmës dhe produktet që kanë bazë qumështin natyror", ka thënë ai.

Kryeministri ka pohuar se AVUK-u është duke punuar intensivisht, duke marrë mostra në terren nëpër markete të ndryshme, për t'u siguruar që produktet që shiten e kanë përbajtjen në bazë të etiketës. "Unë e di sa problem është dhe sa vështirë e ka sot i gjithë ky sektor i prodhimit dhe përpunimit të qumështit. Do t'ju qëndrojmë afër duke inspektuar

në mënyrë rigoroze tregun, për t'u siguruar se konsumatorët dinë çfarë blejnë, pra kur të hyjnë në markete këto produkte të shiten në dy lokacione të ndryshme brenda marketit dhe në të njëjtën kohë AVUK-u do të jetë shumë i angazhuar në terren për të marrë mostra gjithkund dhe për t'i bërë testimet e nevojshme. Është kompetencë ligjore e AVUK-ut dhe Ministrisë së Tregtisë dhe obligim ligjor që të funksionojnë, të jenë rigoroze në terren ndaj atyre që e shkelin ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, duke mos i shitur produktet ashtu siç shkruan në etiketë", ka deklaruar Hoti.

Hoti ka theksuar se do t'u ndihmojmë fermerëve dhe përpunuesve të qumështit me të

gjitha kapacitetet ligjore që kanë në dispozicion. "Po punojmë edhe me Ministrinë e Bujqësisë që t'u dalim në ndihmë fermerëve dhe përpunuesve të qumështit në këtë kohë të vështirë jo vetëm për ata, por edhe për shumicën e sektorëve në vend. Sektori i qumështit ka efekte multiplikuese në krejt zinxhirin e bujqësisë, andaj është tepër i rëndësishëm, prandaj sot kemi ftuar konferencë për media për të bërë të qartë para fermerëve dhe përpunuesve të qumështit, se do të jemi afër tyre në mbështetje me të gjitha kapacitetet ligjore që i kemi në dispozicion, por sigurisht duke respektuar edhe tregun dhe konkurrencën ligjore në treg", ka deklaruar kryeministri Hoti.



## Krasniqi shkon në veri të vendit, zotohet për luftim të informalitetit dhe krimin të organizuar në atë pjesë

Prishtinë, 24 shtator (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka vizituar të enjten pikën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Jarinjë. Po ashtu, bashkë me inspektorë kanë shkuar në një pikë karburanti ku inspektorët kanë marrë mostrat e naftës dhe benzinës për t'i kryer

analizat me qëllim që të vërtetohet nëse përbajtja është në përputhje me standardet dhe ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Nga aty ministri i MTI-së është zotuar se do ta luftojë informalitetin dhe krimin e organizuar në tërë territorin e Republikës së Kosovës.



## Në Gjilan inaugurohet Qendra Burimore për Fëmijët e moshës 3-4 vjeç

GJILAN, 24 SHTATOR (ER) - Në Gjilan është inauguruar të enjten Qendra Burimore për Fëmijët e moshës 3-vjeç në Shkollën Filllore "Abaz Ajeti", projekt ky që është mbështetur nga UNICEF dhe Ambasada Japoneze në Kosovë. Me rastin hapjes së kësaj qendre, nënkryetari Arbër Ismajli e ka vlerësuar UNICEF-in si familjen e dytë në mbarë botën për fëmijët. "UNICEF ka qenë me neve edhe gjatë kohës së pandemisë me shumë pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë. Kjo që po shohim në këtë është jashtëzakonisht një e arritur e madhe, pasi shumë fëmijë do të përfitojnë nga kjo qendër. E falënderoj shumë UNICEF-in,

Ambasadën Japoneze dhe Ministrinë e Arsimit për mundësinë", ka thënë nënkryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli.

Ambasadori japonez në Kosovë, Ogasawara Mitsunori, ka thënë se ndihet i lumtur që kanë arritur të investojnë në këtë projekt. "Jam shumë i lumtur që kemi arritur të investojmë këtu. Nëpërmjet kësaj pako e cila iu shërben fëmijëve me materiale të ndryshme. Kjo është dëshmi se do të vazhdojmë mbështetjen sepse e shohim shumë të rëndësishme t'ju qëndrojmë afër fëmijëve në Kosovë", ka thënë ambasadori Mitsunori. Ndërkohë drejtori i UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, ka pohuar se këtë projekt e ka



mbështetur edhe Ambasada Japoneze, Uta Ibrahim i përmes fondacionit të saj, derisa e ka falënderuar edhe Ministrinë e Arsimit për

bashkëpunimin e ngushtë. Në këtë takim fjalë falënderimi ka shprehur edhe drejtori i shkollës "Abaz Ajeti", Arsim Bejtullahu. Në këtë qendër do

t'i ndjekin mësimet 25 fëmijë të moshës 3-4 vjeçare, kurse është paraparë që të vazhdohet edhe me grupin e dytë të nxënësve.

## Certifikohen edhe 100 ndërmarrës të rinj në Ferizaj



FERIZAJ, 24 SHTATOR (ER) - "Sa kënaqësi t'i certifikoj edhe 100 ndërmarrës të rinj në Republikën e Kosovës. Ferizaj ka potencial ekonomik. Ritmi i zhvillimit po shkon mbarë si rezultat i vullnetit të ndërmarrësve të rinj" ka thënë të enjten ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Vlora Dumoshi. Ajo ka thënë se si ministre, nëpërmjet kushteve konform kornizës financiare të MKRS-së, secilit të ri po i jep mundësi të prodhojë vlerë biznesi në ambientet e tregut të lirë. "Në programin e kryeministrit Hoti, politika më e favorshme është relacioni i të rinjve në

punësim direkt. Ky është bilanci i suksesit për ne. Vetëm kjo siguron zhvillim të brendshëm ekonomik. Nuk jemi shtet konsumues. Jam e lumtur që kemi një rini të qëndrueshme. Kemi imazh të mirë, prandaj dua që rinia të ndihet e sigurt në vendin e vet", ka deklaruar Dumoshi.

## Inspektohen supermarketet në Komunën e Prizrenit

PRIZREN, 24 SHTATOR (ER) - Drejtorja e Inspektoratit ka bërë inspektimin e supermarketeve në Komunën e Prizrenit. Gjatë inspektimit është bërë krahasimi i çmimit të produkteve në reklamacion dhe në arkën e pagesës, është kontrolluar afati i përdorimit të produkteve dhe largimi i disa

prej tyre, si dhe janë kontrolluar flamujt e origjinës së produkteve. Drejtorja e Inspektoratit në Prizren ka ftuar qytetarët të raportojnë çdo parregullsi që hasin, të cilët do të shqyrtohen me vëmendje nga inspektorët e tregut si mbrojtësit më të mëdhenj të konsumatorëve.



## Fshati Strelc i Epërm në Deçan do të bëhet me objekt të ri të QMF-së

Deçan, 24 shtator (ER) - Me qëllim të rritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor në Deçan, Strelc dhe fshatrat përreth, infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të Deçanit po i shtohet edhe objekti i ri i QMF-së në Strelc të Epërm. Lajmin e ka dhënë ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj. "Së bashku me kryetarin e Deçanit, z. Bashkim Ramosaj,

nënshkruam memorandumin për 'Ndërtimin e Objektivit të Qendrës të Mjekësisë Familjare' në Strelc të Epërm, me vlerë 260 000 euro. Pos investimeve në infrastrukturë, pritet shtim edhe në personelin mjekësor, duke konfirmuar se kjo komunë do ta ketë mbështetjen e plotë", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Zelanda e Re lehtëson rregullat për maska

WELLINGTON, 24 SHTATOR - Maskat e fytyrës nuk janë më të detyrueshme në transportin publik, në pjesën më të madhe të Zelandës së Re, pasi numri i rasteve me koronavirus vazhdon të bie. Nga mesnata e së mërkurës, maskat do të kërkohen

vetëm në Aukland, epiqendrën e shpërthimit të fundit të koronavirusit dhe në aeroportin. Zelanda e Re është vlerësuar gjerësisht për trajtimin e pandemisë dhe jeta e përditshme atje është kthyer kryesisht në normalitet në mua-

jin qershor, por virusi është rishfaqur në Aukland në gusht. Ky qytet, më i madhi në Zelandën e Re, i është rikthyer izolimit të përkohshëm. Autoritetet thanë se mbulimi i fytyrës nuk është i nevojshëm për publikun e gjerë,

pasi nuk ka prova të transmetimit të koronavirusit në komunitet tash e dhjetë ditë. Në total, Zelanda e Re ka konfirmuar 1 468 raste me koronavirus dhe 25 viktima. Sipas të dhënave të Institutit "Johns Hopkins", koronavirusi ka prekur mbi 31.8



milione njerëz në të gjithë botën. Prej tyre, mbi 976 000 kanë vdekur dhe afro 22 milionë janë shëruar.

## BE-ja refuzon ta njohë Lukashenkën si president të Bjellorusisë

BRUKSEL, 24 SHTATOR - Bashkimi Evropian refuzon ta njohë Alyksandr Lukashenkën si president të Bjellorusisë. Kështu ka thënë të enjten shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell. "BE-ja nuk i njeh rezultatet e falsifikuara (të zgjedhjeve në Bjellorusi). Bazuar në këtë, i ashtuquajturin inaugurim i 23 shtatorit dhe mandati i ri, i pretenduar nga Alyksandr Lukashenka, nuk kanë asnjë legjitimitet

demokratik", ka deklaruar Borrell, duke shtuar se ky 'inaugurim' bie ndesh me vullnetin e pjesës më të madhe të popullsisë bjelloruse. Zgjedhjet në Bjellorusi janë mbajtur më 9 gusht, por opozita dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë thënë se votimet janë manipuluar në favor të Lukashenkës. Që atëherë, mijëra bjellorusë, përkundër shtypjeve nga policia, protestojnë duke kërkuar

dorëheqjen e Lukashenkës. Të mërkurën, në një ceremoni të paparalajmëruar, Lukashenka bëri betimin për mandatin e gjashtë presidencial. Kjo shkaktoi protesta masive dhe bllokim të rrugëve në Bjellorusi. Policia u përgjig me topa uji dhe rrahje me shkopinj. Edhe Shtetet e Bashkuara kanë thënë se nuk e njohin Lukashenkën si president legjitim të Bjellorusisë.



## BE-ja kërkon shtrëngim të masave dhe kontroll të vatrave të reja me Covid-19



BRUKSEL, 24 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) u ka bërë thirrje vendeve anëtare që t'i forcojnë urgjentisht masat për t'i kontrolluar vatrave të reja të epidemisë dhe për të shtypur valën e re të koronavirusit. "Të gjitha vendet duhet t'i zbatojnë

menjëherë dhe me kohë masat në shenjat e para të pikave të nxehta të reja, nga testimi deri te sigurimi i kapaciteteve spitalore", ka thënë komisionarja evropiane për Shëndetësinë, Stella Kirjakides. Ajo paralajmëroi në konferencën

për shtyp se ky mund të jetë shansi i fundit për ta shmangur përsëritjen e situatës siç ishte pranvera e kaluar. Sipas të dhënave më të fundit, më shumë se pesë milionë njerëz janë të infektuar me virusin korona në Evropë.

## Prodhuesit e makinave padisin Trumpin për taksat mbi Kinën



NJU JORK, 24 SHTATOR - Prodhuesit e mëdhenj makinash janë duke paditur Qeverinë e Shteteve të Bashkuara për taksat e importit që ka vendosur mbi pjesët kineze. "Tesla" është bërë firma e fundit e automjeteve që i kundërshton detyrimet doganore, të paraqitura nga administrata e presidentit

Donald Trump dhe kërkon rimbursime. Tesla ka thënë se tarifatat janë "arbitrarë" dhe "abuzim me lirinë e veprimt". ShBA-ja dhe Kina kanë vendosur taksa kufitare mbi mallrat dhe shërbimet e njëra-tjetrës në kuadër të një lufte tregtare. Një numër padish raportohet të

jenë paraqitur, ditët e fundit, nga prodhuesit e makinave në Gjykatën e Tregtisë Ndërkombëtare në Nju Jork. Mercedes-Benz, në padinë e tij, e ka akuzuar Uashingtonin për "ndjekjen e një lufte të paparë dhe të pakufizuar tregtare, që ka ndikuar në mbi 500 miliardë dollarë importe nga Republika Popullore e Kinës".

## Kina "zgjeron" kampet e paraburgimit në Ksinjiang


KSINJIANG, 24 SHTATOR - Rrjeti i Qendrave të Paraburgimit në Rajonin Ksinjiang të Kinës është shumë më i gjerë sesa mendohet, zbulon një hulumtim i bërë nga një institut austrian. Numri i objekteve ku Kina besohet se ka ndaluar më shumë se 1 milion ujgurë dhe pakica të tjera kryesisht mysli-

mane, është rreth 40 për qind më i madh se vlerësimet e mëparshme, thuhet në raportin e Institutit të Politikave Strategjike në Australi. Sipas raportit, rrjeti i këtyre objekteve është në rritje, me gjithë pretendimet e Kinës se shumë ujgurë janë liruar. Ujgurët janë bashkësia më e

madhe indigjene turqishtfolëse në Ksinjiang, e pasuar nga kazakët. Shumë prej tyre janë vendosur në kampe nga regjimi kinez qysh në vitin 2017. Ka dëshmi se në kampe ushtrohet torturë, përdhunime dhe abuzime të tjera. Kina thotë se atje ka programe trajnimit dhe arsimimi dhe se me to luftohet ekstremizmi.



# Charles Bukowski: Patëm vendosur të çonim ilaçe në Afrikë, por tek të gjithat shkruhej – pas buke!



## THËNIE NGA CHARLES BUKOWSKI

- Nuk e di për të tjerët, por kur unë zgjohem në mëngjes dhe vesh këpucët, mendoj: Zot, po tani çfarë?
- Do të të duhet të vdesësh disa herë përpara se të jetosh me të vërtetë.
- Shumë shpesh njerëzit ankohen se ata nuk kanë bërë asgjë me jetën e tyre; dhe pastaj ata presin që dikush t'ju thotë se kjo nuk është kështu.
- Gjenialitet do të thotë të kesh aftësinë për të thënë një gjë mjaft të thellë në mënyrë të thjeshtë.
- Ne të gjithë do të vdesim, të gjithë ne, çfarë cirku. Kjo duhet të na bënte të gjithë të donim njëri-tjetrin por jo. Ne jemi të terrorizuar nga rivaliteti me njëri-tjetrin.
- Pa letërsi, jeta është një ferr
- Disa njerëz nuk bëjnë asnjëherë çmendurira, sa të tmerrshme duhet të jenë jetët e tyre.
- Nëse do ta provosh me të vërtetë, shko deri në fund. Ndryshe, as nuk e ke filluar fare. Nuk ekziston një ndjenjë më e mirë se sa ajo. Do të jesh vetëm me Zotat. Një luftë e vërtetë
- Ne jemi këtu për t'i jetuar jetët tona aq mirë, sa që vdekja të trembet për të na marrë.
- Problemi me pijen është ky: mendova teksa pija. Nëse një gjë e keqe ndodh, ti pi për të harruar, por nëse diçka e mirë ndodh, atëherë pi për të festuar, dhe nëse nuk ndodh asgjë, ti pi për të bërë diçka të ndodhë.
- Të pirit është një gjë emocionale. Të nxjerr nga rutina e jetës së përditshme, nga të qenit çdo ditë njësoj. Të vendos me shpatulla pas murit. Kam ndjesinë se të pirit është një formë vetëvrasjeje ku të lejohet të kthehesh në jetë dhe ta fillosh jetën nga fillimi. Është si të vrasësh veten e më pas të ringjallesh. Besoj se deri tani kam jetuar 10-15mijë jetë
- Mbahu për birra. Birra është një gjak i përhershëm; një dashnore e përrjetshme...
- Mendoj që kemi nevojë për një pije. Pothuajse të gjithë kanë nevojë, thjesht nuk e dinë.
- Më pëlqen t'i ndryshoj shpesh dyqanet e pijeve sepse nëpunësit fillojnë t'i dinë zakonet e tua nëse ke shkuar çdo natë dhe ke blerë sasi të mëdha alkooli. E ndjej tek mendojnë se si ka mundësi që nuk kam vdekur akoma dhe kjo më bën të mos ndjehem rehat. Mbase ata nuk e mendojnë diçka të tillë, por kjo më është kthyer në paranojë
- Të deheshe ishte diçka e mirë. Vendosa se gjithnjë do më pëlqente të bëhesha tapë.
- Patëm vendosur të çonim ilaçe në Afrikë... por, tek të gjithat shkruhej: pas buke!
- Të shkruash poezi nuk është e vështirë. Të jetosh është e vështirë.
- Secili ka të metat e tij, dihet. Por unë isha tri herë më lart se persekutorët e mi.
- Kaloja para dyqind vetave dhe nuk arrija të shikoja qoftë dhe një qenie njerëzore.
- Mendoni për miliona veta që jetojnë së bashku edhe pse nuk iu pëlqen, e urrejnë punën por kanë frikë ta humbasin, nuk ka pse të çuditësh që e kanë atë fytyrë të cilën e kanë.
- Jam i sigurt që do të më jepet një minutë për t'i menduar të gjitha herët që doja ta ulërija atë që ndjeja, por kam heshtur nga frika se nuk do të kuptohem, dhe do të pendohem për synimet të cilat i kam braktisur ngaqë frika se do të dështoja më ka ndaluar t'i vazhdoja.
- Kjo jetë është një e përdalë. Shkon kështu çakërçejf, sepse ka çaste që të lënë shije të hidhur në gojë, e të tjera çaste
- aq të bukura sa të bëjnë të harrosh paudhësitë e pafundme të jetës.
- Ndryshimi midis një demokracie dhe një diktature është se në një demokraci ti voton një herë e pastaj i merr urdhrat; në një diktaturë nuk e shpenzon fare kohën duke votuar.
- Nëse një ditë më dëgjoni të flasë për dashuri, e yje... ju lutem, më vrisni!
- Filloni ta shpëtoni botën duke shpëtuar një njeri çdo herë; gjithçka tjetër është romantikë madhështore ose politikë.
- Është e mundur të dashurosh një qenie njerëzore nëse nuk e njeh atë më tepër se duhet.
- Ka gjithmonë diçka që na i rrënon jetët tona. Gjithçka varet se cila prej tyre nga bie hise e para.
- Ne të gjithë jemi pengje dhe jemi të gatshëm të merremi peng.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita dhe Shkëndija eliminohen nga Liga e Evropës



**VARSHAVË, 24 SHTATOR** - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani është eliminuar nga Liga e Evropës, pasi pësoi humbje të enjten nga Legia (2-0). FC Drita ka bërë një paraqitje solide në Varshavë para një skuadre të madhe evropiane. Skuadra e Legias ka shënuar dy golat e fitores në pjesën e parë. Dominimi i vendasve ishte në fillim të pjesës së parë, por Drita u mbajt mirë deri në minutën e 24-të, kur Pawel Wszolek shënoi gol me kokë. Kur mendohej që pjesa e parë e ndeshjes do të përfundonte me këtë rezultat Legia shënoi edhe

golin e dytë dhe të fundit në ndeshje Tomas Pekhart. Drita u paraqit mirë në pjesën dytë, por nuk arriti të rrezikojë seriozisht portën e vendasve dhe ndeshja përfundoi me rezultat 2-0. Megjithatë, kampioni i Kosovës bëri historinë duke u kualifikuar për herë të parë në rrethin e tretë të Ligës së Evropës. KF Shkëndija është eliminuar nga Liga e Evropës nga Tottenham Hotspur. Ishte një ndeshje që u fillua shumë mirë nga Tottenham të cilët erdhën në epërsi që në minutën e pestë të ndeshjes. Pas një gabimi në mbrojtje i Shkëndijës, Erik Lamela

realizoi golin e parë. Pavarësisht se kishte disa mundësi shënimi Tottenham nuk shënoi dhe pjesa e parë përfundoi me rezultat 0-1. Në pjesën e dytë Shkëndija e nisi shumë më mirë ndeshjen se Tottenham dhe ata barazojnë rezultatit me një gol të bukur të Nafiu në minutën e 54-të. Pas golit Shkëndija filloi ta këtë një dominim kundër londinezëve por që nuk zgjati gjatë pasi që në minutën e 70 në skenë del jugkoreani Soon që shënon një gol pas një devijimi. Rezultatit përfundimtar e vulosi Harry Kane (1-3).

## Bayerni fiton edhe Superkupën e Evropës

**BUDAPEST, 24 SHTATOR** - Bayern Munchen e ka fituar Superkupën e Evropës, pasi në finale e mposhti skuadrën e Sevillas (2-1). Fituesja e Ligës së Evropës, Sevilla kaloi e para në epërsi në minutën e 13-të, kur nga penalltia u tregua i saktë Lucas Ocampos. Në minutën e 34-të, Bayerni u rikthyer në lojë me golin e shënuar nga Leon Goretzka. Pjesa e parë u mbyll më këtë rezultat, sikurse që u mbyll edhe pjesa e dytë. Skuadrat shkuan në vazhdimë për të përcaktuar fituesin. Bayerni arriti të gjejë golin e epërsisë në minutën e 104-të, kurse zëvendësuesi Javier Martinez shënoi me kokë për rezultatit final 2-1.



### SHKURT

#### Loci, trajner i Rahovecit

Trajneri pejan Bujar Loci do të jetë trajner i Rahovecit në edicionin ri 2020/2021. Lajmin e ka konfirmuar vetë klubi i Superligës së Kosovës në basketboll. "Përkundër faktit se si rrodhën gjërat së fundi në kampin tonë, ai është pajtuar me bordin e ri për ta vazhduar bashkëpunimin e filluar para pandemisë", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci. Loci edhe në të kaluarën ka qenë trajner i Rahovecit, kurse në edicionin e kaluar ishte trajner i Prishtinës dhe në të kaluarën ka drejtuar Pejën.

#### Ajeti nënshkruan për Reggianan

Arlind Ajeti do ta vazhdojë karrierën në Serinë B me skuadrën e Reggianas. Ish-futbollisti kuqezi ka firmosur të enjten kontratë dyvjeçare me skuadrën e Reggianas. Prej dy vjetësh mbrojtësi nuk po kalon çaste të mira, teksa është përcjellë edhe nga lëndimet. Nga shkurti i sezonit të kaluar mbrojtësi ishte pjesë e Vejle në Danimarkë, teksa në merkaton e janarit u përfol edhe për një interesim të Tiranës për mbrojtësin, diçka që nuk u konkretizua.

#### Kasimpasa dëshiron ta blejë Hadërgjonajn

Futbollisti i Kosovës, Florent Hadërgjonaj, karrierën mund ta vazhdojë në Turqi. Futbollisti "dardan" e kaloi sezonin e fundit në ekipin Kasimpasa në formë huazimi nga Huddersfieldi. Mirëpo, mediat britanike shkruajnë se klubi turk po mendon ta blejë përfundimisht mbrojtësin e djathtë. Futbollisti i rritur në Zvicër kishte mbetur jashtë skuadrës angleze në sezonin 2019/2020 dhe kishte vendosur që në janar t'i bashkohej Kasimpasas. Ditët e fundit flitej se Hadërgjonaj do t'i bashkohej Olympiakosit, por klubi grek nuk arriti marrëveshje me Huddersfieldin.

#### Thaçi dhe Miftaraj paditin Prishtinën në FFK

Ish-kapiteni i Prishtinës, Armend Thaçi dhe Diar Miftaraj, prej muajit të kaluar nuk janë më pjesë e klubit më të madh në vend. Thaçi u transferua te Ballkani, ndërsa Miftaraj ende nuk e ka bërë zgjedhjen. Pavarësisht se ndarja ishte me përshëndetje falënderuese, Prishtina ende nuk u ka shlyer obligimin e mbetur sipas kontratës. Thaçi ka konfirmuar ankesën e dërguar në FFK. "Po, e kam dërguar lëndën në FFK, përmes së cilës kërkoj të më shlyhen të gjitha obligimet që shkruhen në kontratën që kam pasur me Prishtinën", ka thënë Thaçi për "Olle". "Sigurisht se pres të më paguhen, sepse është djersa ime që është dashur ta marr para një viti", ka shtuar ai. Mbrojtësi i djathtë i Ballkanit, që së fundi u grumbullua edhe me Kosovën, thekson se ka biseduar paraprakisht me drejtuesit e Prishtinës. "Më kanë thënë se të lajmërohemi, por më nuk më janë përgjigjur", ka treguar Miftaraj. Ai nuk ka dashur ta zbulojë shumën e parave ose periudhën e muajve të papaguar nga Prishtina, ndërsa Miftaraj nuk ka dashur të flasë për padinë, duke mos mohuar dërgimin e lëndës në federatë.

## Miami, afër finales së madhe

ORLANDO, 24 SHTATOR - Miami Heat është shumë pranë finales së madhe të NBA-s. Skuadra nga Florida fitoi përballjen e katërt të serisë (3-1) ndaj Boston Celticsit

me rezultatin 112-109, e udhëhequr nga Tyle Herro, që u shfaq në formën e tij më të mirë. "Rookie" i Heat, i hedhur në lojë nga stoli, shënoi rekordin e karrierës


së tij, duke realizuar plot 37 pikë. Tashmë ai është vetëm pas Magic Johnsonit në histori për numrin e pikëve të shënuara në moshën 20-vjeçare. Kontribut të vyer në

këtë sukses të Heat dha edhe Jimmie Butler me 24 pikë e 9 "rebounde", ndërsa për Celticsin nuk mjaftoi Jayson Tatum me 28 pikë e 9 rikuperime.



# Belegu: Liga Unike risi në basketboll, shpresoj në cilësi dhe rivalitet

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ish-gjyqtari i njohur i Kosovës, Mithat Belegu, ka folur për formimin e Ligës Unike mes Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës së Basketbollit të Shqipërisë. Belegu ka dhënë kontribut të madh në basketbollin e Kosovës, duke qenë basketbollist shumë i dalluar, gjyqtar me thirrje ndërkombëtare e vëzhgues për shumë vite. Ai e komenton në këtë mënyrë krijimin e Ligës Unike. "Çdo risi për basketbollin e Kosovës është e mirëseardhur. Më herët nuk është menduar krijimi i kësaj lige për shkak se Kosova nuk ka qenë e pranuar në FIBA apo pengesave të ndryshme. Megjithatë, tashmë Liga Unike është formuar dhe do të shohim se si do të funksionojë", është shprehur Belegu për faqen zyrtare të FBK-së. Ish-gjyqtari i njohur shpreson se nuk do të ketë pengesa për zhvillimin e kësaj lige. "E vetmja pengesë mund të jetë pandemia, që shpresoj se nuk



do të pengoj. Skuadrat duhet të përgatiten për këtë ligë. Të zhvillojnë stërvitjet siç duhet, ndeshjet miqësore dhe më pas ndeshjet zyrtare. Gjithashtu, shpresoj se lojtarët vendorë do të kenë më shumë hapësirë, sidomos basketbollistët e rinj. Jo të gjithë basketbollistët e huaj kanë qenë shumë cilësorë, andaj mund t'u jepet rasti të rinjve", nënvizoi Belegu, duke shtuar: "Shpresojmë se do të ketë cilësi dhe rivalitet e të rritet interesimi për basketboll si në Kosovë, po ashtu në Shqipëri. E

theksoj edhe një herë se është një risi në basketboll dhe të shpresojmë se do të ngrehen cilësia dhe interesimi në të dyja vendet", u shpreh Belegu, i cili ishte basketbollist më i mirë i Kosovës në vitet '60. Ishte tri herë shënuesi më i mirë në Ligën e Dytë të Ish-Jugosllavisë dhe më pas u bë gjyqtar, kurse në vitin 1978 u bë gjyqtar ndërkombëtar i FIBA-s. Në Ligën Unike do të marrin pjesë katër skuadrat më të mira nga Kosova dhe katër më të mirat nga Shqipëria.

# Suarezi me lot largohet nga Barcelona, kalon në Atletico

BARCELONË, 24 SHTATOR - Luis Suarez ka shpërthyer në lot disa herë në konferencë për media të organizuar për nder të tij, pasi uruguaiani i dha fund një epoke prej gjashtë vjetësh te Barcelona. Ai shprehu mirënjohje për besimin që i kishte dhënë klubi, ndërsa tani do ta vazhdojë karrierën tek Atletico Madridi. Ai uli perden në "Nou Camp", duke thënë se ai do të jetë gjithmonë tifoz i klubit. Fillimisht ai e kishte të vështirë të fliste, por e pranoi se Barcelona kishte "nevojë për ndryshime" dhe trajneri i ri Ronald Koeman nuk kishte besim tek ai. Kur flitet për besimin e klubit, ai u kthye në kohën kur Barcelona nënshkroi me të nga Liverpooli në verën e 2014-s, pavarësisht kafshimit të tij ndaj Giorgio Chiellinit në Kupën e Botës, që e dënoi me katër muaj moslojë. "Klubi gjithmonë ka pasur caq shumë besim tek unë që nga viti 2014 kur më mori. Klubi më besoi duke ditur edhe kushtet që



erdhën pas gabimit që unë bëra. Kur unë erdha këtu, ata më rrethuan me besim, nuk ishte e lehtë për mua, por trajnerët dhe shokët e skuadrës, mënyra se si më pranuan kur erdha, ishte e mahnitshme", ka thënë Suarez. "Të gjithë njerëzit e dinë sakrificën që unë bëra në këto vite për të ardhur në Barcelonë dhe për të luajtur për ekipin më të mirë në botë. Jam i vetëdijshëm që jemi në fund të një epoke, por duhet të jem shumë krenar për gjithçka që

kemi bërë", ka shtuar Suarez. Suarez e pranoi se ishte trajneri i ri i Barcelonës, Ronald Koeman, që nuk e donte atë si pjesë të ekipit të tij. "Klubi kishte nevojë për ndryshime dhe trajneri nuk llogariste tek unë. Dua të tregoj se akoma mund të performoj në një nivel të lartë. Unë po bashkohem me Atletico Madridin me shumë entuziazëm, por ende nuk kam menduar se si do të jetë të luash kundër Barcelonës", ka thënë Suarez.

## SHKURT

### Mbahet mbledhja e parë e Bordit të Ligës Unike

Është mbajtur mbledhja e parë e Bordit të Ligës Unike, ku i pranishëm ka qenë edhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, drejtori i Ligës Unike, Dren Zatriqi, si dhe legjenda e basketbollit shqiptar Vaso Shaka. Në këtë takim është biseduar për fillimin dhe rrjedhën e Ligës Unike, kurse janë marrë vendime të rëndësishme për zhvillimin e kësaj lige. Entuziazmi dhe dëshira është e madhe për fillimin e Ligës, ku do të luajnë katër skuadrat më të mira nga Kosova dhe katër më të mirat nga Shqipëria. Liga Unike pritet të fillojë në fund të muajit tetor, kurse dy skuadrat e para në renditje kualifikohen në gjysmëfinale të "play-off"-it, kurse për dy vendet e tjera do të garojnë 3 vs. 6 dhe 4 vs. 5.

### Mendy prezantohet te Chelsea

Skuadra e Chelseat ka njoftuar se ka kompletuar transferimin e portierit Edouard Mendy nga Rennes. 28-vjeçari është larguar nga Rennes, për t'u bashkuar skuadrës nga 'Stamford Bridge'. "Chelsea ka kompletuar transferimin e portierit Edouard Mendy nga Rennes", thuhet në njoftimin e Chelseas. "Reprezentuesi i Kombëtares së Senegalit ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare në 'Stamford Bridge' dhe do të konkurrojë me Kepa Arrizabalaga dhe Willy Caballero për vendin e titullarit".

### De Boer zëvendëson Koemanin në Kombëtaren e Holandës

Pas përvojave të dështuara me Interin, Crystal Palace dhe Atlanta United në Major League Soccer, Frank De Boer rikthehet në bankinë për të drejtuar një tjetër skuadër të madhe. 50-vjeçari është zgjedhur nga drejtuesit e federatës holandeze të futbollit si pasuesi i Ronald Koeman në stolin e përfaqësueses portokalli. De Boer, i cili në karrierën e tij është aktivizuar në 112 ndeshje me Holandën, duke shënuar edhe 13 gola, ka firmosur një kontratë dyvjeçare deri në përfundim të Botërorit Katar 2022. Do të jetë ai që do ta udhëheqë Holandën në Evropianin e verës së ardhshme, por edhe që do të tentojë ta rikthejë në një kampionat botëror nëpërmjet ndeshjeve kualifikuese.

### Rudiger e humbet vendin e titullarit te Chelsea, Barça përgatit ofertën

Klubi i Barcelonës po vazhdon ndryshime, derisa tash e kërkon qendërmbrojtësin e Gjermanisë, Antonio Rudiger, i cili është pjesë e Chelseat. Mbrojtësi gjerman ka përfunduar si zgjedhje e pestë e trajnerit Frank Lampard për repartin defensiv. Diçka e tillë e shtyn të largohet dhe ofertat nuk mungojnë. "Kicker" raporton se drejtuesit e Barcelonës kanë nisur bisedimet me agjentin e lojtarit dhe shumë shpejt do të prezantojnë një ofertë zyrtare për "Blutë e Londrës".

### Në 'Tokio 2020' vetëm ata që dalin negativë nga koronavirus

Organizatorët e Lojërave Olimpikë "Tokio 2020", eventit më i madh sportiv në botë, i shtyrë për verën e vitit të ardhshëm si pasojë e pandemisë Covid-19, kanë deklaruar se në këtë Olimpiadë do të lejohet të vijnë dhe garojnë vetëm sportistët që do të jenë negativë nga koronavirusi. Të gjithë ata që do të hyjnë në Tokio duhet të kenë kryer tamponin të paktën në 72 orët e fundit. Në Olimpiadë zakonisht marrin pjesë 11 mijë sportistë nga 200 vende të botës. Aktualisht Japonia ka mbyllur dyert për personat që vijnë nga 159 shtete të botës, ku Covid-19 vijon ende të ketë nivel të lartë infektimi. Përveç tamponit, të gjithë sportistët duhet të shkarkojnë një aplikacion në celularët e tyre, i detyrueshëm, i cili do ta monitorojë gjendjen e tyre shëndetësore 24 orë. Ky është një vendim i marrë nga Qeveria e Japonisë. Gjithashtu, asnjë sportist nuk do të lejohet t'i përdorë mjetet e transportit publik gjatë Olimpiadës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/Opština Dragaš / Daragas Municipality



Dt.24/09/2020

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. Dhe 2. te Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, kërkesës së drejtorit të QKMF Dragash me nr.02.111/01-17519 dt.18/09/2020,aprovimit nga kryetari i Komunes së Dragash-it Shërbimi I Personelit K.Dragash shpallë:

### KONKURS për Komunitete

- Vendi i Punës;Punëtor teknik-Pastrues në QKMF,QMF dhe AMF-fsh.Brod K.Dragash
- Niveli i pages; H-74 314 eu bruto
- Periudha e kontrates;12 muaj me mundësi vazhdimi
- Oret e punes;40 orë në javë
- Pergjegjës-mbikqyrës ;Drejtori i QKMF

#### Kushtet për punëtor teknik-pastrues :

- Të jenë shtetas/e të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer shkollën fillore ;
- Të jetë një entuziast dhe i /e aftë për të punuar;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik ;

#### Detyrat dhe përgjegjësit

- Të bëjë pastrimin dhe të mirëmbajë higjienën mbrenda objektit të QKMF-së dhe jashtë objektit;
- Të bëjë menagjimin e mjetëve medicinale dhe djegëjen e tyre në inserator , pastrimin e objektit si dhe pastrimin e oborrit të objektit të QKMF-së
  - Kryerja e detyrave tjera sipas udhëzimit të mbikqyrësit;
  - Aplikacionet merren në zyrën e Personelit nr.9 -K.Dragash;
  - Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet:
  - Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, diploma fotokopje e vërtetuara te noteri,vertetimi për përvojën e punes;
  - Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim;
  - Afati i konkurimit është **15 ditë** nga dita e publikimit në gazetë;

Vërejtje;Kandidatët të cilet konkurojnë për këtë pozitë duhet të jenë qytetar të integruar në institucionet e Republikës së Kosovës.

Shërbimi i Personelit  
Dragash

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Grasep" Sh.p.k. Sllatinë e Epërme, Viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për përpunimin dhe konservimin e perimeve dhe pemëve në Sllatinë e Epërme komuna Vitisë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.10.2020 në ora 10:00 në zyrat e kompanisë "Grasep" sh.p.k në fshatin Sllatinë e Epërme në komunën e Vitisë do të organizohet debat publik nga kompania "Grasep" Sh.p.k. Sllatinë e Epërme, Viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për përpunimin dhe konservimin e perimeve dhe pemëve në Sllatinë e Epërme komuna Vitisë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/8607564026?pwd=SEVVU2QyVkE5U09LZi81WnJOWHhwdz09>

Meeting ID: 860 756 4026

Passcode: Xg2Yat

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/Opština Dragaš / Dragas Municipality



Dt.24/09/2020

U skladu sa članom 8 stav 1. i 2. Zakona o Radu Republike Kosova br. 03 / L-212, zahtev direktora GCPM-a O. Dragaš br. 02.111 / 01-17519 dt.18 / 09/2020, odobreno od strane predsednika Opštine Dragaša, Kadrovska služba objavljuje:

### KONKURS (za zajednice)

- Radno mesto: Tehnički radnik-Čistač objekta GCPM-a, CPM-a, APM-a Brod-O.Dragaš
- Nivo plate: H-74 314 eu bruto
- Period ugovora: 12 meseci sa mogućnošću produženja
- Radni sati: 40 sati nedeljno
- Nadležno lice: Direktor GCPM-a

#### Uslovi tehničkog osoblja-čistač:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Da ima završenu osnovnu školu;
- Da bude entuzijasta i sposoban za rad;
- Da ima sposobnost efikasno rada u multietničkom okruženju;

#### Dužnosti i odgovornosti.

- Da čisti i održava higijenu unutar i izvan objekta GCPM-a,;
- Da izvršava druge dužnosti prema nalogu nadzornika;
- Aplikacije se uzimaju u kancelariji Kadrovske službe br.9 -O.Dragas.
- Aplikaciji se prilažu dokumenti: lična karta, ekstrakt rođenih, fotokopija diploma sertifikovana od strane notara, potvrda o radnom iskustvu.
- Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati.
- Rok za konkurs je **15 dana** od dana objavljivanja u novinama.

**Napomena:** Kandidati koji konkurisu za ovu poziciju trebaju biti integrisani građani u institucijama Republike Kosova.

Kadrovska služba O.Dragas

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► Burim Selmani shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Zendelj Sata shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Ferid Jonuzi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Myzafere Ahmetaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Kabashit " Korish.

► Misko Karaleic shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Dardan Nuh Gashi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" në Prishtinë.

► Gjensia mandall shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 C, të shkollës së mesme, Gjimnaziumi i përgjithshëm "Loyola Gymnasium", Prizren.

► Greta Thaqi shpall të pavlefshme dëftesën si dhe diplomën e shkollës së mesme "Ekonomike" Prishrinë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



Në bazë të Nenit 21.1 të Ligjit për Ndërmarrje publike (Ligji nr. 03/L-087), UA MPMS nr. 07/2017, Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01-2456/17 dhe Vendimit të Komisionit për Auditim të PK Sh.A. nr. 01-1501/2020, datë 27.08.2020, PK Sh.A. shpall këtë:

### KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

**Titulli i pozitës: Zyrtar/e i/e Auditimit të Brendshëm/ i/e PK Sh.A., grada 16**

**Nr. Referencës: 01-1700/20**

**Përshkrimi:** PK Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A. ofron mundësi të barabartë punësimit të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Korporatës, në përputhje me metodat dhe praktikatat moderne.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Konform nenit 4 dhe 15 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës nr. 01-2456/17, të datës 20.09.2017, kontrata e punës është për kohë të caktuar në kohëzgjatje prej tri (3) viteve, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

**Aplikimi:** Aplikacionet mund të merren online [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com) dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: **Arkivi i PK Sh.A., Ndërtesa Kryesore e PK-së, Rr. 28 Nëntori nr. 4, 10000 - Prishtinë**, deri në afatin e paraparë për aplikim me shenjë "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk iu kthehen aplikantëve. Aplikacionit patjetër duhet t'i bashkëngjitet apo të sillet më vonë tek RNJ e PK Sh.A. dëshmia (vërtetimi) së aplikanti/ja nuk është nën hetime dhe i/e dënuar.

**Afati i fundit për aplikim: 24/10/2020, ora 16:00.**

**Pozita: Zyrtar/e Kryesor/e i/e Auditimit të Brendshëm**

**Raportin te: Komiteti i Auditimit PK Sh.A.**

**Grada: 16**

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ushtron funksionin në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministria e Financave;
- Vepron në përputhje me Standardet e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit dhe Kodin e Etikës;
- Harton dhe dorëzon planin strategjik dhe planin vjetor për rishikim dhe miratim të udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik, konkretisht Komisioni i Auditimit;
- Bën rishqyrtimin e proceseve vendimtare të biznesit, duke vlerësuar efikasitetin e kontrollimeve të brendshme dhe duke identifikuar mundësitë e përmirësimit të mundshëm të procesit;
- Vlerëson rrezikun e proceseve kryesore të biznesit që rezultojnë me përgatitjen e planeve dhe programeve specifike të auditimit;
- Identifikon dobësitë e kontrollimit të brendshëm përmes proceseve të auditimit dhe mundësitë për përmirësim;
- Përgatit raporte të auditimit duke identifikuar përparësitë dhe dobësitë, përfshirë dhënien e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
- Mbikëqyrë punën e Zyrës së Auditimit
- Rishqyrton dhe dokumenton rezultatet e punës së auditimit të kryer nga stafi i auditimit;
- Prezanton tek Komisioni i Auditimit raportet e auditimit për aprovim;
- Përcjell zbatimin e rekomandimeve bazuar në raportet e auditimit dhe planeve të veprimit të ndërmarrjes;
- Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me natyrën e punës së tij/saj, por që nuk bien në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi;
- Përbush çfarëdo detyrë tjetër të përcaktuar nga ana e Komitetit të Auditimit.

#### Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

- Të përmbush kriteret e ndërmarrjes sipas nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrje Publike;
- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë;
- Certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor, në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave;
- Ekspert i certifikuar në kontabilitet apo ndonjë fushë tjetër në kuadër të financave;
- Përvojë pune mbi 3 vite në fushën e auditimit të brendshëm;
- Të zhvillojë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale për ta rrajtur certifikatën e tij/saj profesionale duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) viteve të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 22 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregullores në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për NP dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;
- Aftësi të dëshmuara të udhëheqjes, me zotësinë që në mënyrë efikase të punojë nëpër të gjitha nivelet dhe funksionet brenda ndërmarrjes;
- Proaktiv dhe i përcaktuar në rezultate/metricë;
- Njohja e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar është përparësi;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze.

#### Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i),
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën për Auditor të Brendshëm,
- Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,
- Letër Motivimin,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.



Na osnovu člana 21.1, Zakona o javnim preduzećima (Zakon br. 03/L-087), Administrativnim Uputstvom Ministarstva za Rad i Socijalne Zaštite (MRSZ) br. 07/2017, Pravilnik o regulisanju radnih odnosa 01-2456 / 17 i Odluka Komisije za reviziju PK A.D, br. 01-1501 / 2020, od 27.08.2020, Pošte Kosovo A.D., objavljuje :

### JAVNI KONKURS ZA RADNO MESTO

**Naziv radnog mesta: Službenik/ica Interne Revizije PK A.D., rang, 16**

**Referentni Br: 01-1700/20**

**Opis:** PK D.D. ulaže napore da razvija poslovanje u skladu sa najsavremenijim iskustvima poštanskih i komercijalnih usluga, kako bi dostigla međunarodne standarde u pružanju poštanskih i komercijalnih usluga. S tim u vezi, PK A.D. pruža jednake mogućnosti zapošljavanja profesionalcima kojima je cilj da budu deo korporativnog poslovnog razvoja i kompetencija, u skladu sa modernim metodama i praksom.

**Trajanje ugovora:** U skladu sa članovima 4. i 15. Pravilnika o regulisanju radnih odnosa za zaposlene u Pošti Kosova br. 01-2456/17, od 20.09.2017, ugovor o radu je za određeno vreme u trajanju od tri (3) godine, u koji period je uključen probni rad od 6 meseci.

**Aplíciranje:** Aplikacije se mogu preuzeti online na web stranici [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com) i zajedno sa relevantnim dokazima poslati poštom na adresu: **Arhiva PK A.D., Glavna zgrada PK, Ul. 28. novembar Br. 4, 10000 - Priština**, do isteka roka za apliciranje sa oznakom „ZA KONKURS“, navodeći naslov radnog mesta za koji se prijavljujete.

Aplikacija i svi dokazi mora biti priložen fotokopiran, jer se isti ne vraćaju podnosiocima zahteva.

U aplikaciji mora se priložiti, ili doneti kasnije predstavnicima Ljudskih Resursa PK A.D., dokaz (potvrda) da podnosilac zahteva nije pod istragom ili osuđen.

**Zadnji rok za prijavu: 24/10/2020, do 16:00 časova.**

**Pozicija: Glavni Službenik/ica za Unutrašnju Reviziju**

**Izveštava: Odbor za reviziju PK A.D.**

**Rang: 16**

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Vršiti funkciju na objektivan, profesionalan način i u skladu sa odredbama Zakona o unutrašnjoj kontroli javnih finansija br. 06/L-021 i metodologiju interne revizije za javni sektor, odobreno od Ministarstva finansija;
- Postupa u skladu sa Standardima Interne Revizije, Statutom Revizije i Etičkim Kodeksom;
- Izrađuje i podnosi strateški plan i godišnji plan na razmatranje i odobranje šefu Entiteta Javnog Sektora, konkretno Komisiji za reviziju;
- Pregleda kritične poslovne procese, ocenjujući efikasnost unutrašnjih kontrola i identifikujući mogućnosti za potencijalno poboljšanje procesa;
- Vršiti procenu rizika ključnih poslovnih procesa koji rezultira pripremom specifičnih planova i programa revizije;
- Identifikuje slabosti interne kontrole kroz procese revizije i mogućnosti za poboljšanje;
- Priprema revizorske izveštaje koji identifikuju snage i slabosti, uključujući davanje preporuka i zaključaka;
- Nadgleda rad Kancelarije za Reviziju;
- Pregleda i dokumentuje rezultate revizorskog rada koje je izvršilo revizorsko osoblje;
- Podnosi revizorske izveštaje u Odboru za reviziju na odobrenje;
- Prati primenu preporuka zasnovanih na revizorskim izveštajima i akcionim planovima preduzeća;
- Obavlja druge zadatke koji se odnose na prirodu njegovog / njenog posla, ali koji nisu u suprotnosti sa važećim pravilima i zakonima;
- Ispunjava sve druge dužnosti koje je dodelio Odbor za reviziju.

#### Potrebna kvalifikacija i iskustvo:

- Ispuniti kriterijume preduzeća prema članu 13 Zakona br. 04 / L-111, o izmeni i dopuni Zakona o javnim preduzećima;
- Univerzitetaska diploma iz ekonomije;
- Sertifikat internog revizora u javnom sektoru, koju izdaje Ministarstvo finansija ili potvrda za internog revizora u javnom sektoru od strane relevantne međunarodne ili lokalne institucije, u skladu sa kriterijumima izdatim od Ministarstva finansija;
- Sertifikovani stručnjak za računovodstvo ili bilo koju drugu oblast u oblasti finansija;
- Radno iskustvo preko 3 godine u oblasti interne revizije;
- Kontinuirano razvijati profesionalna znanja i veštine da održi svoj/lu profesionalni sertifikat učešćem u šezdeset (60) sati obuke u roku od dve (2) uzastopne godine, u skladu sa kriterijumima utvrđenim u članu 22. Zakona o unutrašnjoj kontroli javnih finansija br. 06/L-021;
- Dobro poznavanje važećih zakona i propisa, sa posebnim naglaskom na Zakon o Javnim Preduzećima i drugi zakoni koji se odnose na unutrašnju kontrolu i finansijsko upravljanje;
- Dokazane liderske veštine, sa sposobnošću efikasnog rada na svim nivoima i funkcijama u preduzeću;
- Biti proaktivan i definisan u rezultatima / metrici;
- Poznavanje standarda računovodstva i finansijskog izveštavanja je prednost;
- Preferirano znanje engleskog jezika.

#### Kandidat mora da podnese ove dokaze:

- Aplikacija,
- CV,
- Dokaz o obrazovanju (diplome stečene u inostranstvu mora nostrifikovati Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije),
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Sertifikat za internog revizora,
- Reference, kao i drugi profesionalni sertifikati,
- Motivaciono pismo,
- Dokaz da nije pod istragom (ne starije od 3 meseca),
- Kopija identifikacionog dokumenta.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

